



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
01 Nr.020/01-13669/1
Dt.27.07.2019
D r a g a s h

N J O F T I M

Në bazë të neneve 17 e 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, në seancën e VI-të (të jashtëzakonëshme)/2019 të Kuvendit Komunal të Dragashit, të mbajtur më 27.06.2019, pas njoftimit paraprak, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Drafti i Propozim-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës-Dragash, për vitet 2020-2022.
- II. Teksti i Draftit të Propozim-Kornizës Afatmesme Buxhetore është transparent në web-faqen e Komunës Dragash (linku “Shpalljet”, apo Drejtorati i Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit-Dragash, ku edhe adresohen vërejtjet apo plotësimet eventuale gjatë fazës së diskutimit publik i cili përmbyllet me një takim **më dt.13.09.2019 (e premte) në sallën e Kuvendit Komunal në Dragash, në ora 10,00,** ndërsa Korniza Buxhetore, si dokument kryesor zhvillimor i Komunës, miratohet deri në fund të Shtatorit/2019, me Vendimin e buxhetit të Komunës së Dragashit, për vitin 2020).
- III. Për implementimin e këtij Vendimi obligohen Drejtorati për Ekonomi, Financa e Zhvillim (Zyrtari i Lartë Financiar) në bashkëpunim me kryesuesin e KK-së dhe kryetarin e Komunës-Dragash.
- IV. Për hapat e ndërmarr njoftohet Kuvendi Komunal-Dragash.

I dërgohet :

- Kryetarit të Komunës Dragash z.Shaban Shabani,
- Drejtorit të Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës-Dragash z.Valon Shaban,
- Zyrtarit të Lartë Financiar të Komunës-Dragash z.Burim Aliu,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH
Kryesuesi
Betim Merdiu.d.v.

